



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 57, datë 21.06.2013

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 9, DATË 08.02.2007 “MBI
BAZAT, METODAT E LLOGARITJES SI DHE MËNYRAT E MBAJTJES SË
PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMEVE TË JO-JETËS”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Drejtorisë së Administrimit të Riskut, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 9, datë 08.02.2007 “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës” (e ndryshuar), sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Në Rregulloren nr. 9, datë 08.02.2007 “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës” (e ndryshuar), bëhen ndryshimet si më poshtë:

➤ Në aneksin 2 , Tabela II (për dëmet e ndodhura) bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në rreshtin e tretë të tabelës pas fjalisë “Të dhëna lidhur me dëmin” shtohen:

- *numri personal (ID) i shkaktarit të aksidentit,*
- *vendndodhja (qyteti) e aksidentit,*
- *kapaciteti motorik i mjetit shkaktar të aksidentit,*
- *mosha e shkaktarit të aksidentit,*
- *gjinia e shkaktarit të aksidentit,*
- *cilësimi, nëse shkaktari i aksidentit është përdorues apo pronar i automjetit.*

2. Në rreshtin e tretë të tabelës pas togfjalëshit “targat (për sigurimet motorike)” shtohet togfjalëshi **“për automjetin shkaktar dhe përfitues”**.

3. Në rreshtin e 14-të të tabelës pas fjalës “refuzuar” shtojmë fjalën **“e rihapur”**.

4. Pas rreshti i 15-të shtohet **rreshti i 16-të me përmbajtje “Monedha e dëmit të vlerësuar” dhe rreshti i 17-të “Vlera e shpenzimeve mbi trajtimin e dëmit”**.

5. Pas rreshtit të 18-të shtohet **rreshti i 19-të me përmbajtje “Shënime (në këtë kolonë shoqëria e sigurimit të japë detaje mbi dëmet e refuzuara, në proces gjyqësor, si dhe dëmet e rihapura)”**

➤ Në paragrafët sqarues, pas Tabelës II (për dëmet e ndodhura) bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë pas fjalës “të paguara” shtohet fjala **“të rihapura”**.

2. Shtohet paragrafi i dytë, me përmbajtje si më poshtë:

“Çdo praktikë dëmi e regjistruar në bazën e të dhënave për dëmet e ndodhura, pavarësisht statusit të praktikës duhet të ketë një vlerësim nga shoqëria e sigurimit. Për praktikat e dëmeve për të cilat shoqëria e sigurimit ka mungesë dokumentacioni në vlerësimin e plotë të vlerës së dëmit, në varësi të llojit të dëmit, në bazën e të dhënave të dëmeve duhet të mbaj si provigjon një vlerë dëmi minimalisht sa vlera mesatare e tij në vite, deri në plotësimin e praktikës së dëmit me dokumentacionin e nevojshëm për të caktuar vlerën reale të dëmit të shkaktuar.”

3. Shtohet paragrafi i katërt, me përmbajtje si më poshtë:

“Të dhënat e përcaktuara në Tabelën I (të dhëna mbi rreziqet e kontraktuara nga shoqëria) dhe Tabelën II (për dëmet e ndodhura), do të shërbejnë si bazë për llogaritjen e provigjoneve teknike të shoqërisë së sigurimit, si dhe në përcaktimin dhe

vlerësimin e primeve të rrezikut dhe tarifave për produktet në të cilat shoqëria e sigurimit është licencuar nga Autoriteti për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit. “

4. Paragrafi i fundit, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Këto të dhëna raportohen në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare së bashku me llogaritjet e provigjoneve teknike, brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, si dhe me depozitimin e kërkesës së aplikimit të tarifave të reja për produktet e sigurimit.”